

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERËVE
DEGA TIRANË
Nr.1619REP.
Nr.797KOL.

Taksa e pullës u pagua



KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot më datë 16.08.2019 (dy mijë e nëntëmbëdhjetë), ditën e premte, përpara meje noterit SOKOL Sh. MALAJ, anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterëve, Dega Tiranë, me adresë Rruga “Luigj Gurakuqi”, Pallat i ri, para meje Noterit u paraqitën personalisht palët:

PALA SHITËSE :

Z. GHANIM SAAD M ALSAAD AL-KUWARI i biri i Saad Maged Alsaad Al-Kuwary dhe Aisha Ali Darwish lindur në Qatar më 23.08.1964, banues në Salwa Road, Zone 40, Street 954, Building Nr 17, Doha, Qatar, i identifikuar me Pasaportën e Qatar Nr 01217064, i cili në bazë të Prokurës së posaçme me Nr.1496REP dhe Nr.736KOL të datës 31.07.2019, akt i hartuar/ noterizuar nga Noter Sokol Sh. MALAJ, Noter në Tiranë, prokurë kjo e nënshkruar prej tij në prani të Noterit në Doha, Qatar, përfaqësohet nga **Z. RAMIZ ZEKAJ** i biri i Mustafa dhe Zylfije lindur në Novosellë, Kosovë më 10.02.1965, banues në Tiranë, Rr”Isuf Elezi”, Blloku i Vilave Selitë, Nr 10, i identifikuar me Pasaportën BI7486501 me Nr personal #G50210232Q#, aktualisht përdorues i telefonit Nr 00355672063701.—

PALA BLERËSE:

Z. RAMIZ ZEKAJ i biri i Mustafa dhe Zylfije lindur në Novosellë, Kosovë më 10.02.1965, banues në Tiranë, Rr”Isuf Elezi”, Blloku i Vilave Selitë, Nr 10, i identifikuar me Pasaportën BI7486501 me Nr personal #G50210232Q#, aktualisht përdorues i telefonit Nr 00355672063701.—

Palët e mësipërme janë madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar të cilët pasi u sqaruan për pasojat juridike që sjell ky akt noterial më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate shitje kuotash si më poshtë:

KUSHTE PARAPRAKE:

1. Pala shitëse në bazë të Ekstraktit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, është ortak me 100 kuota të cilat përbejnë 100% të kapitalit të shoqërisë “C.I.T” SHPK, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 14.04.2011, me NIPT L11614010R.
2. Kapitali i shoqërisë është 965.000 All (nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë lekë), dhe pala shitëse është zotëruar i 100 kuotave të cilat përbejnë 100% të kapitalit të shoqërisë.

3. Sipas rezultatit të kërimit të lëshuar nga Regjistri i Barrëve Siguruese, për palën shitëse, nuk ka asnjë barrë të regjistruar.
4. Ortaku ka vendosur, transferimin nëpërmjet shitjes të kuotave që ai zotëron, të cilat përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë "C.I.T" shpk, palës blerëse **Z.RAMIZ ZEKAJ**.
5. Çmimi i shitjes në bazë të marrëveshjes së arritur mes palëve jashtë kësaj zyre është caktuar në vlerën 965.000 All (nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë lekë). Kjo shumë i është likuiduar palës shitëse nga pala blerëse përpara nënshkrimit të këtij akti noterial dhe jashtë kësaj zyre noteriale me para në dorë (CASH).

Neni 1- Baza Ligjore

Kjo kontratë lidhet në bazë të nenit 705 e vijues te Kodit Civil Shqiptar, Nenit 73, paragrafi 1, shkronja c e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 « Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare », i ndryshuar.

Neni 2 - Objekti i kontrates

Pala shitëse, transferon me anë të kësaj kontrate, me vullnet të lirë e të plotë në përputhje me Kodin Civil te Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe Statutit të Shoqërisë, kuotat që ai zotëron, me vlerë të përgjithshme 965.000 All (nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë lekë), që përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë "C.I.T" SHPK.

Neni 3- Garancitë

Pala shitëse përmes përfaqësuesit të saj deklaron dhe garanton se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotave që transferohen nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

Neni 4- Heqje dore nga të drejtat

Pala shitëse përmes përfaqësuesit të saj deklaron nën përgjegjësinë personale, se heq dorë nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në cilësinë e ortakut të shoqërisë, pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 5- Detyrimet

Pala shitëse, duke filluar nga kjo datë nuk do të ketë asnjë përgjegjësi të çfarëdo natyre për çfarëdo aktiviteti të së kaluarës ose të ardhshëm në lidhje me "C.I.T" shpk.

Neni 6- Efekte ligjore

1. Pas realizimit të këtij transferimi, me nënshkrimin e kësaj kontrate :

- **Z. RAMIZ ZEKAJ**, bëhet ortak i shoqerisë me 100 kuota të cilat përbejnë 100% te kapitalit të shoqerise.
- **Z. GHANIM SAAD M ALSAAD AL-KUWARI** largohet si ortak i shoqerise.
- Administrator i shoqerise do të jetë **Z. RAMIZ ZEKAJ**.

2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate pala shitëse humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotat e kapitalit që transferon, të drejta të cilat janë transferuar tek pala blerëse dhe se nuk ka asnjë pretendim për çmimin e shitjes i cili i është likujduar plotësisht.

Neni 7- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo lloj mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë u hartua në 4 (kater) ekzemplarë me vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe, dhe ju lexua palëve, te cilet deklaruan se e kuptuan aktin e mësipërm dhe se janë dakord me sa më sipër, dhe e nënshkruan rregullisht përpara meje dhe unë noteri, e vërtetoj atë sipas ligjit.

PALA SHITËSE
Z. GHANIM SAAD M ALSAAD AL-KUWARI
i cili përfaqësohet nga
Z. RAMIZ ZEKAJ

Ramiz Zeqaj
R.

PALA BLERËSE
Z. RAMIZ ZEKAJ

Ramiz Zeqaj
R.

SOKOL SH. MALAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEGA VENDORE E NOTERISË TIRANË
NR—1496—REP
NR—136—KOL



PROKURË E POSAÇME

Në bazë të nenit 70 e vijuesa të K.Civil

Sot më datë 31.07.2019 (dy mijë e nëntëmbëdhjetë), ditën e Mërkurë, perpara meje noterit SOKOL Sh. MALAJ, anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterëve, Dega Tiranë, me adresë Rruga “Luigj Gurakuqi”, Pallat i ri, mbi kërkesën e shtetasit **Z. GHANIM SAAD M ALSAAD AL-KUWARI** shkova në Doha Qatar, ku para meje Noterit u paraqit personalisht palët:

POROSITËSI:

Z. GHANIM SAAD M ALSAAD AL-KUWARI i biri i Saad Maged Alsaad Al-Kuuary dhe Aisha Ali Darwish lindur në Qatar më 23.08.1964, banues në Salwa Road, Zone 40, Street 954, Building Nr 17, Doha, Qatar, i identifikuar me Pasaportën e Qatar Nr 01217064.—

I lartpërmenduri është madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar i cili deklaron se nuk e kupton gjuhën shqipe dhe asistohet prej meje Noterit në gjuhën Angleze, dhe pasi u sqarua për pasojat juridike që sjell ky Akt-Noterial deklaroi sa vijon:—

“Me cilësinë e ortakut të Vetëm të shoqërisë “C.I.T” shpk, **Emëroj përfaqësues të posaçëm, Z. RAMIZ ZEKAJ** i biri i Mustafë dhe Zylfije lindur në Novosellë, Kosovë më 10.02.1965, banues në Tiranë, Rr”Isuf Elezi”, Blloku i Vilave Selitë, Nr 10, i identifikuar me Pasaportën BI7486501 me Nr personal #G50210232Q#, aktualisht përdorues i telefonit Nr 00355672063701, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.—

Përfaqësuesi i emëruar prej meje, ka të drejta dhe kompetenca të plota të disponojë në të gjitha format e parashikuara nga ligji kuotat e mia të kapitalit që unë kam në shoqërinë “C.I.T” shpk, si ORTAK I VETËM (pra 100 kuota të cilat përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë).—

Për këtë qëllim Përfaqësuesi i caktuar prej meje ka të drejtën të nënshkruajë Vendimin e Ortakut të vetëm si dhe aktin noterial për shitjen ose dhurimi e këtyre kuotave **vetëm në favor të tij** (pra **vetëm në favor/pronësi të Z. RAMIZ ZEKAJ**, pasi Unë nuk kam asnjë pretendim apo mosmarrëveshje.—

Në rast të likuidimit me Kontratë shitje, Ai ka të drejtën të bëjë likuidimet përkatëse të shumës që unë kam rënë dakord të shes.—

Veç sa sipër, përfaqësuesi im, ka të drejtë të më përfaqësojë në mbledhjet e Asamblesë/Ortakut të vetem, të marrë pjesë dhe të nënshkruajë vendimet përkatëse pranë Noterit lidhur me shitjen ose dhurimin e këtyre Kuotave, si dhe çdo vendim-marrje tjetër kurdoherë në interesin tim dhe të shoqërisë, pasi unë nuk kam asnjë pretendim.—


Ai ka të drejtën të nënshkruajë dhe aktin e nevojshëm Noterial, për lirimin e barrës siguroese të Shoqërisë, në favor të bankës kredidhënëse BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SHA.—

Në rast mosmarrëveshje Ai ka të drejtën të ndjekë zgjidhjen e saj si pranë Organeve të administratës shtetërore apo institucioneve private dhe në rast se çmohet prej tij ka të drejtën të caktojë avokat për të mbrojtur dhe përfaqësuar interesat e mia pasurore në rrugë gjyqësore në të gjitha instancat gjyqësore si në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë deri në zgjidhjen përfundimtare të saj, duke i kaluar atij të gjitha kompetencat e mësipërme.—

Lidhur me këtë veprim dhe për realizimin e kësaj Porosie, Përfaqësuesi im, ka të drejtën të paraqitet vetë(apo të caktojë Përfaqësues tjetër) pranë QKB për të regjistruar këtë veprim, si dhe për të tërhequr Ekstraktin e ri të shoqërisë me ndryshimet e rastit.—

Pra, përfaqësuesi i emëruar prej meje ka të drejta dhe kompetenca të plota të nënshkruajë çdo akt noterial që lidhet me realizimin e porosive të sipërcituara.—

Veç sa më sipër, Përfaqësuesi im ligjor ka të drejtë të kryejë dhe çdo veprim tjetër ligjor që lidhet me sa mësipër, pavarësisht faktit që nuk përmendet në këtë akt noterial, por duke vepruar kurdoherë në mirëbesim dhe në mbrojtje të interesave të mia si porositës, vullnet i cili është shprehur edhe në Vendimin e Ortakut të vetëm të Shoqërisë.—




UNË të gjitha veprimet e tij që lidhen me sa më sipër, i konsideroj të drejta e të mirëqëna me fuqi të plotë ligjore e të pakontestueshme njëllëj sikur të isha vetë prezent me anën e kësaj prokure të posaçme të hartuar me vullnetin tim të lirë e të plotë në rezidencën e ortakut të vetëm të Shoqërisë në Doha Qatar, në prezencë të Noterit."—

Kjo prokurë është e vlefshme deri sa të revokohet në mënyrë të ligjshme nga porositësi dhe të komunikohet ligjërisht revokimi i saj në bazë të nenit 76 të K.Civil.—

Për të vërtetuar sa më sipër u hartua kjo Prokurë e Posaçme e cila si u lexua dhe u gjet sipas vullnetit të porositësit u nënshkrua sipas ligjit në praninë time dhe unë Noteri e vërtetoj atë rregullisht.—


POROSITËSI

Z. GHANIM SAAD M ALSAAD AL-KUWARI


Ghanim Saad Al Saad.

NOTER

SOKOL SH. MALAJ



REPUBLIC OF ALBANIA

LOCAL BRANCH OF NOTARY TIRANA

NO—1486—REP

NO—736—KOL

POWER OF ATORNEY

—Based on article 70 of the Civil Code—

Today on 31.07.2019 (two thousand nineteen), on Wednesday, before me the Notary SOKOL Sh. MALAJ, member of the Notary Chamber, Branch of Tirana with address Rruga “Luigj Gurakuqi”, Pallat i ri, with the request of the citizen **Z.GHANIM SAAD M ALSAAD AL-KUWARI** I went in Qatar, at the residence of the Sole Member of the Company and before me the Notary was presented personally:

AUTHORIZER: Mr. GHANIM SAAD M ALSAAD AL-KUWARI son of Saad Maged Alsaad Al-Kuwary and Aisha Ali Darwish born in Qatar on 23.08.1964, resident in Salwa Road, Zone 40, Street 954, Building Nr 17, Doha, Qatar, identified with the Passport of Qatar Nr 01217064.—

The above mentioned is major with full juridical ability to act, whom whom declares that doesnt understand the albanian language and is asisted by me the Notary in the English language and after was explained of the legal consequences that has this Notary act and declare as below:

“With the quality of the sole member of the company "C.I.T" shpk, I name as my representative, **Mr. RAMIZ ZEKAJ** son of Mustafa and Zylfije born in Novosellë, Kosovo on 10.02.1965, resident in Tirana, Rr”Isuf Elezi”, Blloku i Vilave Selitë, Nr 10, identified with the Passport BI7486501 with personal No #G50210232Q#, currently user of the phone No 00355672063701, major with full juridical ability to act.—

The representative appointed by me has full rights and powers to dispose in all the forms provided by the law the capital quotas that I have in the company "C.I.T" shpk, as a SOLE MEMBER (so 100 shares which constitute 100% of the capital of the company).

For this purpose, the Representative appointed by me has the right to sign the Sole Member Decision and the Notary Act for the sale or donation of these quotes only in his favor (so only in favor / ownership of Mr. RAMIZ ZEKAJ, as I do not I have no pride or disagreement.

In the case of liquidation with a sale contract, he has the right to make the corresponding liquidation of the amount I have agreed to sell.

In addition, my representative has the right to represent me at the meetings of the Assembly / sole Member, attend and sign the relevant decisions to the Notary regarding the sale or donation of these quotes, as well as any other decision-making at any time my interest and society, as I have no claim.


He has the right to sign the necessary notarial act for the release of the company's securing liability in favor of the lending bank BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SHA (UNITED BANK OF ALBANIA SH.A).

In case of disagreement, HE has the right to pursue its settlement as close to the State Administration organs or private institutions and in case it is appreciated it has the right to appoint a lawyer to protect and represent my property interests in litigation at all instances such as in the Tirana District Court, the Court of Appeal and the High Court until its final resolution, bypassing all of the above competencies.

Regarding this action and for the realization of this Order, my Representative has the right to present himself (or assign another Representative) to the QKB to register this action as well as to withdraw the new Company Extract with the occasional changes.

Therefore, the representative appointed by me has full rights and powers to sign any notarial act related to the execution of the above mentioned orders.

In addition, my Legal Representative has the right to perform any other legal action related to the above, regardless of the fact that it is not mentioned in this notarial act, but always acting in the interest of and protection of my interests as a customer, the will which is expressed in the Decision as a Sole Member of the company.

A handwritten signature in black ink, consisting of a series of loops and horizontal strokes, positioned at the bottom of the page.


I, all his actions related to the above, I consider as right and good with full legal and indisputable power as if I were present, with this special act drafted with my free will and full at the residence of the Sole Member of the Company in Doha Qatar, in the presence of the Notary.

This Authorization is valid until the time of my revocation as 76 of the Civil Code.—

To certify the foregoing, I, the Notary, prepared this Contract for Leasing a vehicle, which was read and confirmed by both contract parties willingly, and was signed by them in my presence and I, the Notary, certify it regularly.—

THE AUTHORIZATOR

Mr. GHANIM SAAD M ALSAAD AL-KUWARI


Ghanim Saad Al Saad.

NOTARY

SOKOL SH. MALAJ



VËRTETIMI I NDRYSHIMIT TË REGJISTRIMIT

Informacioni i mëposhtëm është regjistruar në Regjistrin e Barrëve Siguruese

INFORMACION I PËRGJITHSHEM

Numri i Regjistrimit:	B-2019081513511039
Lloji i Ndryshimit:	Fshirje (Per te fshire regjistrimin nga sistemi)
Numri i Regjistrimit që Ndryshohet:	A-20180712131506777
Data e Ndryshimit të Regjistrimit:	15.08.2019
Ora e Ndryshimit të Regjistrimit:	1:51:10PM
Numri i Dokumentit:	B-303-001-869
Referenca e Perdoriesit:	839
Emer Debitori:	C.I.T

PERSONI REGJISTRUES:

<u>Emri i Personit Fizik/Juridik</u> EM BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE S.H.A.	<u>Adresa</u> RR. DURRESIT, ZOGU I ZI J91811004Q TIRANE-TIRANE SHQIPERI Tel: 2227408 Fax: 2228460 Email:
--	--

NËNSHKRIMI I AUTORIZUAR:

Emri i Personit Fizik/Juridik
RAIMONDA BOCI

